



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 305/15 prot.

Datë 09.04.2026

V E N D I M
Nr.491/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Gjergj Mersini	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 09.04.2026, mori në shqyrtim çështjen me,

- Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të KPP nr. 283/2026, datë 19.02.2026, për procedurën e prokurimit “E hapur”, me REF-67987-11-06-2025, me objekt: Marrëveshje kuadër “Sistemim Asfaltim i Rrugeve ne territorin e Njesise Administrative Nikel , Bashkia Kruje”, , me fond limit 59,215,513.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 25.11.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Krujë.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “BE - IS” SHPK, me NIPT K71412003A, dhe adresë Godina Nr.2, Heci Veleshice, Kalis, Zall Kalis, Kukes.
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Krujë
Adresa: Kruje Qender Sheshi Mustafa Merlika (Kruja).
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit te Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datën 19.02.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.283/2026 ku vendosi:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “BE - IS” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur”, me REF-67987-11-06-2025, me objekt: Marrëveshje kuadër “Sistemim Asfaltim i Rrugeve ne territorin e Njesise Administrative Nikel , Bashkia Kruje”, , me fond limit 59,215,513.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 25.11.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Krujë.
2. Autoriteti kontraktor të rivlerësojë ofertën e operatorit ekonomik “BE - IS” SHPK, sipas konstatimeve të shprehura në këtë vendim.
3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të njoftojë Komisionin e Prokurimit Publik mbi zbatimin e vendimit duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “BE - IS” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 2529 prot., datë 07.04.2026 protokolluar me tonën nr. 305/12 prot., datë 09.04.2026 autoriteti kontraktor njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr. Nr.283/2026 datë 19.02.2026, për procedurën e prokurimit “E hapur”, me REF-67987-11-06-2025, me objekt: Marrëveshje kuadër “Sistemim Asfaltim i Rrugeve ne territorin e Njesise Administrative Nikel , Bashkia Kruje”, , me fond limit 59,215,513.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 25.11.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Krujë

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton:

II.1 Me shkresën nr. 2529 prot., datë 07.04.2026 protokolluar me tonën nr. 305/12 prot., datë 09.04.2026 autoriteti kontraktor njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr.283/2026 datë 19.02.2026, për procedurën e prokurimit “E hapur”, me REF-67987-11-06-2025, me objekt: Marrëveshje kuadër “Sistemim Asfaltim i Rrugeve ne territorin e Njesise Administrative Nikel , Bashkia Kruje”, , me fond limit 59,215,513.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 25.11.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Krujë

II.2. Komisioni i Prokurimit Publik verifikoi veprimet e kryera në sistemin e prokurimeve elektronike, lidhur me zbatimin e vendimit Nr.283/2026 datë 19.02.2026, të Komisionit të Prokurimit Publik. Nga ky verifikim rezultoi se, autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësim të procedurës object ankimi, në zbatim të vendimit Nr.283/2026 datë 19.02.2026 të këtij komisioni.

Për sa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur”, me REF-67987-11-06-2025, me objekt: Marrëveshje kuadër “Sistemim Asfaltim i Rrugeve në territorin e Njesise Administrative Nikel , Bashkia Krujë”, , me fond limit 59,215,513.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 25.11.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Krujë
 2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

